



**UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHEVE TË HUAJA  
DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE**

**TEATRI EPIK I BERTOLT BREHTIT  
VËSHTRIM MBI DRAMATURGJINË**

**Punim për gradën “Doktor i Shkencave”  
në letërsinë gjermane**

**Disertante:  
Ma. Marsela Likaj**

**Udhëheqës Shkencor:  
Prof.dr. Josif Papagjoni**

**Tiranë, 2015**



**UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHEVE TË HUAJA  
DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE**

**TEATRI EPIK I BERTOLT BREHTIT  
VËSHTRIM MBI DRAMATURGJINË**

**Punim për gradën “Doktor i Shkencave”  
në letërsinë gjermane**

**KOMISIONI**

- 1. Prof.dr. Irena Ndoci (Kryetare)**
- 2. Prof. dr. Brikena Kadzadej (Oponente)**
- 3. Prof.dr. Saverina Pasho (Oponente)**
- 4. Prof. dr. Ymer Çiraku (Anëtar)**
- 5. Ass. Prof. Ema Kristo (Anëtare)**

## FALËNDERIME

*Me mirënjohje të thellë falënderoj Prof. dr. Josif Papagjonin për ndihmën e tij të vyer, këshillat, sugjerimet, durimin dhe motivimin e përhershëm që më ka dhënë me shumë bujari e pa u kursyer, duke më orientuar dhe drejtuar hap pas hapi gjatë gjithë përgatitjes së këtij punimi. Vërejtjet dhe sugjerimet e tij kanë luajtur pa diskutim një rol të rëndësishëm në hartimin e kësaj teze.*

*Falënderoj kolegët e mi të Departamentit të Gjermanishtes për mbështetjen, inkurajimin dhe sygjerimet e tyre. Do të dëshiroja të falënderoja të gjithë ata që më kanë mbështetur në trajtimin e këtij punimi, realizimi me sukses i të cilit pa ndihmën e tyre nuk do të kishte qenë i mundur.*

*Fjalët e fundit janë në adresë të familjes sime të shtrenjtë, së cilës ia kushtoj këtë punim duke e falënderuar për mbështetjen, durimin dhe mirëkuptimin e treguar gjatë gjithë kësaj kohe.*

## PASQYRA E LËNDËS

### Hyrje

0.1 Përligjja e temës.....	iv
0.2 Objekti dhe hipotezat e studimit.....	v
0.3 Metodologjia dhe struktura e punimit.....	vii

### KREU I - DRAMA MODERNE GJERMANE DHE BERTOLT BREHTI

1. Formimi i personalitetit artistik të Bertolt Brehtit.....	1
1.2. Krijimtaria në mërgim.....	8
1.3. Brehti dhe politika.....	12
1.4. Zhvillimi i dramës moderne në kontekstin historiko-letrar.....	17
1.5. Teori mbi dramën moderne.....	24
1.6. Forma të strukturave joaristoteliane në historinë e dramës gjermane.....	28

### KREU II - ASPEKTE TË TEATRIT EPIK TË BREHTIT

2.1. Teatri epik dhe teoria brehtiane.....	34
2.2. Tipare të dramaturgjisë epike të Brehtit dhe zhvillimi i saj.....	43
2.3. Teknikat e komunikimit epik .....	50
2.3.1. Teknika epike e montazhit.....	54
2.4. Teknikat e tjetërsimit në teatrin brehtian.....	56
2.4.1 Teknikat e tjetërsimit në rrafshin gjuhësor.....	62
2.4.2. Teknikat e tjetërsimit në rrafshin skenik.....	65

### KREU III - DRAMA TË BREHTIT SI MODELE TEATRI EPIK

3.1. Analizë e elementeve epike në dramën “Rrethi kaukazian prej teleshiri” .....	72
3.1.1. Karakteristikat e personazheve në dramë .....	77
3.2. Karakteret dhe tipat shoqërorë të dramës “Nëna Kurajë” .....	81
3.3. Jeta e Galileit në këndvështrimin e teorisë brehtiane.....	84
3.4. “Opera për tri grosh” .....	91
3.5. Pjesët mësimore të Brehtit.....	96

### KREU IV – BREHTI DHE TEATRI POLITIK

4.1. Çfarë është teatri politik.....	100
4.2. Teatri politik në Shqipëri.....	106
4.3. Fashizmi në këndvështrimin e Brehtit.....	108
4.4. Dramat antifashiste të Brehtit.....	113
4.5. Drama “Arturo Ui” si model i teatrit politik.....	120
4.5.1. Elemente të teatrit epik në dramën “Arturo Ui” .....	134

## **KREU V – VËNIA NË SKENË DHE KRITIKA MBI BREHTIN**

5.1. Sukses i ndërkombëtar i dramave të Brehtit.....	136
5.2. Brehti në skenën shqiptare.....	138
5.3. Ndarja në dy kampe e kritikës për Brehtin.....	141
5.4. Koncepte epike të bashkëkohësve të Brehtit.....	149
5.5. Aktualiteti i teatrit epik dhe teorisë brehtiane.....	151
<b>PËRFUNDIME.....</b>	<b>157</b>
<b>Bibliografia.....</b>	<b>166</b>
<b>Shtojca1</b>	
Kronologji.....	173
<b>Shtojca 2</b>	
Bisedë me regjisorin Milto Kutali.....	177

## DY FJALË PËR PUNIMIN

### 0.1 Përligjja e temës

*Zgjedhja e temës së këtij disertacioni në fushën e letërsisë gjermane është bërë për disa arsye. Së pari do të përmendja faktin se Bertolt Brehti renditet ndër shkrimtarët dhe dramaturgët gjermanë më në zë, i cili me një prodhimtari tejet të pasur dhe me një teori të re teatrore ndikoi skenën teatrore gjermane dhe botërore të shekullit XX.*

*Ky punim synon një studim të thelluar të dramës epike të Bertolt Brehtit, i cili konsiderohet një nga dramaturgët më të mëdhenj të shekullit XX që solli risi në shkrimin dhe sidomos në vënien në skenë të kësaj drame. Ai pati një ndikim të madh në shumë autorë të mëvonshëm, dhe renditet ndër dramaturgët më të vënë në skenë në rang botëror. Bertolt Breht është bërë objekt polemikash dhe kritike si në Republikën Federale Gjermane ashtu edhe në Republikën Demokratike Gjermane. Koha ka bërë që dimensionin e veprës së Brehtit të vlerësohet tashmë pa paragjykime.*

*Ndonëse objekti i këtij studimi është drama epike me karakter politik dhe edukativ e Bertolt Brehtit, specifikat që shfaqti procesi i tij krijues dhe realizimi skenik, elementet e reja të propozuara prej tij, qasja ndaj publikut, vështrimi i kritikës, prania dhe ndikimi i modelit të tij teatrore, si edhe trajtimi jo i gjerë i studimeve në gjuhën shqipe, nxisin nevojën për një rrokje më gjithëpërfshirëse të krijimtarisë së tij. Brehti jetoi në një kohë ku ideologjitë mbi bazën e të cilave u ngritën dy sisteme të ndryshme ishin në provë. Njohu kapitalizmin e egër në fillimet e tij dhe natyrshëm, siç pozicionohen shumë shkrimtarë, edhe Brehti u vu në kahun e mbrojtjes së interesave të njerëzve më të dobët të shoqërisë, duke i bërë oponencë sistemit. Bindjet e majta dhe frymëzimi nga teoria marksiste nuk ishte një tipar karakterizues vetëm i këtij autori. Shumë prej autorëve të atyre viteve, veçanërisht autorët evropianë, të cilët përjetuan Luftën e Parë Botërore dhe ndikimin e Revolucionit të Tetorit u pozicionuan në kampin e majtë. Nga ana tjetër ai nuk jetoi zhvlerësimin e ideologjisë komuniste, e cila rezultoi të ishte utopi, ndonëse vitet e fundit shprehu kritikë ndaj mënyrës së të drejtuarit dhe disa veprimeve politike në Gjermaninë Lindore. Për të kuptuar rolin e këtij dramaturgu në zhvillimin e dramaturgjisë gjermane, botërore madje edhe asaj shqiptare nevojitet ta shohim atë si pjesë të sistemit letrar dhe dramaturgjik botëror.*

*Vepra e tij dramatike dhe teoria e tij teatrore erdhi në një kohë kur drama po tentonte hapjen e formës duke eksperimentuar me forma të reja të saj. Botëkuptimi i dramës moderne kishte sjellë një qasje të re në trajtimin e materialit dramatik. Ndryshimet e shpeshta historike, politike dhe shoqërore kërkonin një trajtim më të gjerë dhe krijuan terrenin e nevojshëm për një shtrirje të*

*dramës dhe futjen në të të elementeve epike, të cilat Brehti i shndërroi në gur themeli të teatrit epik.*

*Nga pikëpamja teorike studimi i dramës brehtiane do të kryhet në dy rrafshë, në atë diakronik dhe atë sinkronik. Përmes një vështrimi diakronik të zhvillimit të dramës para ardhjes së tij në letërsinë gjermane do të kuptojmë vlerën që ka vepra e Brehtit dhe vendin që zë ajo në trashëgiminë letrare. Studimi sinkronik na ndihmon të kuptojmë se në ç'raporte është ajo me veprën e bashkëkohësve të vet, të nxjerrim në pah karakteristikat e përbashkëta dhe risitë që ajo sjell.*

*Duke qenë studimi i parë i thelluar në këtë fushë, ky punim synon të kontribuojë në zgjerimin e njohurive lidhur me teorinë dhe praktikën brehtiane si për studentët e gjuhës dhe letërsisë gjermane në veçanti, ashtu edhe studentët e letërsisë dhe dramaturgjisë në përgjithësi.*

*Disertacioni do të ndihmojë gjithashtu në njohjen e mëtejshme të lexuesit shqiptar me këtë personalitet të rëndësishëm të mendimit estetik dhe letrar të kulturës gjermane. Nëpërmjet analizës së veprës, pasqyrimin të mendimit kritik bashkëkohor për veprën dhe praktikën teatrore të Bertolt Brehtit, ky studim do të përpiqet të sjellë një kontribut modest në zhvillimin e kritikës letrare dhe teatrore në Shqipëri.*

## **0.2 Objekti dhe hipotezat e studimit**

*Objekt i këtij studimi është vepra teorike dhe dramatike e Bertolt Brehtit, janë ato pjesë të veprës së tij, të cilat kanë patur një ndikim më të madh dhe janë bërë më së shumti objekt kërkimesh shkencore. Një vëmendje e veçantë i kushtohet teorisë së tij të teatrit epik, të cilën e ka zhvilluar paralelisht me vënien në skenë të pjesëve të tij si pjesë praktike e kësaj teorie. Për sa i përket shkrimeve teorike të autorit jemi fokusuar në analizën e teksteve: “Messingkauf”, „Organoni i vogël për teatrin“ si edhe në „Shkrimet për teatrin“ në të cilat autori ka përcjellë mendime dhe ide për një teatër të ri në përputhje me kërkesat e kohës.*

*Në këtë studim trajtohen pjesët kryesore të tij, si „Nëna kurajo dhe bijtë e saj“, „Njeriu i mirë i Secuanit“, „Shën Johana e therrtove“, „Frikë dhe mjerim në Rajhun e tretë“ etj., të cilat përfaqësojnë shembuj tipikë të teatrit epik dhe kanë patur jehonë botërore. Objekt i këtij studimi janë edhe ato vepra të këtij autori, të cilat janë sjellë në shqip apo edhe janë vënë me sukses në skenat tona, ndër të cilat “Jeta e Galileit“, „Arturo Ui“, „Opera për tri grosh“, „Spiuni“ etj, si edhe ato pjesë që përfshihen në tekstet shkollore dhe universitare, dhe jo vetëm në Gjermani.*

*Rëndësi i kushtohet edhe Brehtit si dramaturg me vënien në skenë të dramave të tij, duke lënë një pasuri të tërë shkrimësh të vlefshme për mënyrën e vënies në skenë të këtyre pjesëve. Elementet*

tjetërsuese në rrafshin gjuhësor, skenik, muzikor, teknikat e montazhit të përdorura gjerësisht në dramën epike, teknika e distancimit të aktorit nga roli dhe gjesti si element shoqëror janë evidentuar dhe analizuar gjatë shqyrtimit të shembujve të ndryshëm në këtë punim.

Studimi do të mbështetet në hipotezën kryesore se krijimtaria e Bertolt Brehtit vjen te lexuesi, spektatori dhe kritika si një vepër eksperimentuese me një larmi teknikash dramatike, të cilat mundësojnë një qasje edukative në trajtimin e temave me karakter historik, politik dhe shoqëror. Për një trajtim më të plotë dhe për t'u dhënë përgjigje të argumentuar çështjeve të ndryshme, në punim janë paraqitur analiza teorike dhe kritika nga studiuesit më përfaqësues në këtë fushë, me një orvatje për një trajtim origjinal që përmban dhe vlerësimin tonë vetiak.

Një hipotezë e rëndësishme e punimit është zhvillimi i teatrit politik në shoqëri në momente kyçe historike. Përvoja e teatrit politik të Brehtit në kushtet e zhvillimeve historiko-shoqërore në periudhën midis dy luftërave botërore mund të vlejë si një model për zhvillimin e këtij lloji teatri në Shqipëri, në kushtet e ndryshimit nga sistemi socialist në atë të ekonomisë së tregut, duke bërë një dallim midis teatrit të agjitpropit të aplikuar rëndom para viteve '90.

Studimi shoqërohet në tërësinë e vet me shembuj analize dramash, me anë të të cilëve synohet perceptimi më i qartë dhe evidentimi i vlerave që përmban kjo praktikë teatrore, si një nxitje për aplikimin e tyre në skenën teatrore shqiptare.

Një tjetër qëllim i rëndësishëm i këtij punimi është që të pasqyrojë mundësitë që ofron praktika teatrore brehtiane në qasjen ndaj temave aktuale historike dhe shoqërore. Në këtë kontekst, studimi synon edhe të tregojë se si mund të kontribuojë kjo teori dhe praktikë teatrore, për të sjellë në skenën shqiptare tematika aktuale me një këndvështrim kritik dhe duke synuar një efekt edukativ shoqëror.

### **0.3 Struktura e punimit dhe metodologjia e studimit**

Gjithë punimi është ndarë dhe strukturuar në pesë kapituj, të cilët përmbajnë nënndarjet përkatëse. Në fund të punimit gjenden përfundimet e përgjithshme të tij.

**Në kreun I** është trajtuar drama në përgjithësi dhe drama moderne në veçanti, ndryshimet në formën e dramës moderne dhe qasja e re në trajtimin e materialit dramatik. Këtu janë trajtuar aspekte biografike dhe historike të veprës së Brehtit, protesta ndaj provincialitetit, përpjekja për një stil të ri teatror, bashkëpunimi në fushën teatrore si edhe ndikimi nga “Studimet marksiste” dhe stili i “Realizmit të Ri”. Jeta e tij u përcaktua në një farë mase nga zhvillimet historike të



shekullit XX që nga fundi i Perandorisë Gjermane e deri te fillimi i Luftës së Ftohtë, kështu që vepra e tij trajton këto zhvillime dhe vjen si një përpjekje për të analizuar me mjete artistike ngjarjet katastrofale të historisë së Gjermanisë, shkaqet politike e shoqërore për të krijuar mundësinë e premisave për një të ardhme më të mirë. Shumë vepra të tij nuk do të kuptoheshin pa njohjen e kontekstit kohor.

**Në kreun II** trajtohen bazat e dramaturgjisë epike dhe zhvillimi i saj. Rëndësi të veçantë në këtë kapitull i kushtohet teorisë së “Teatrit Epik” si një formë e re e propozuar nga Brehti, si edhe analizës së elementeve të veçantë të këtij teatri. Rëndësi i kushtohet strukturave epike në dramë, teknikave të tjetërsimit në teatrin brehtian, ku analizohen përmes shembujve nga drama të ndryshme teknikat e tjetërsimit në rrafshin gjuhësor, në rrafshin skenik dhe në rrafshin muzikor, teknika epike e montazhit. Refuzimi që i bëu Brehti praktikës teatrore të sugestionimit dhe mënyrës emocionale të interpretimit të roleve nga aktorët reflektohet në teknikat e distancimit të aktorit nga roli dhe futjen e elementit të gjestit me një funksion shoqëror, të përshkruara në mënyrë të detajuar në shënimet shoqëruese të pjesëve dhe të analizuar gjerësisht në këtë kapitull.

**Në kreun III** analizohen konkretisht këto elemente në disa nga dramat kryesore të këtij autori, si edhe realizimi i tyre skenik, në kuadrin e “teatrit epik”. Në fokus kryesor të analizës janë vendosur dramat më domethënëse të këtij autori si “Nëna Kurajo dhe bijtë e saj”, “Njeriu i mirë i Secuanit”, “Rrethi kaukazian prej teleshiri”, etj., të cilat paraqiten si modele tipike të “teatrit epik”, tek të cilat ai ka vënë në jetë teorisë e tij mbi këtë lloj teatri.

Rëndësi i është kushtuar edhe përzgjedhjes së dramave të njohura për publikun shqiptar të cilat janë sjellë në shqip apo edhe janë vënë në skenë në mënyrë të pjesshme në periudha kohore të ndryshme. Janë analizuar gjithashtu karakteret shoqërore të përzgjedhur nga Brehti e të vendosur në qendër të dramave të tij, duke vlerësuar edhe mundësinë e kësaj forme teatrore në tipizimin e këtyre karaktereve. Përmes një analize krahasuese të karaktereve theksohen kontraste dhe paralele midis figurave, situatave dhe këndvështrimit mbi to. Rëndësi e teknikës në realizimin dramaturgjik të pjesëve nënvizojnë mundësitë që ofron teatri epik në kontekstin e ri të zhvillimit të dramës. Pjesë e këtij kreu është edhe shqyrtimi i pjesëve edukative të Brehtit dhe roli didaktik i tyre.

**Në Kreun IV**, trajtohet teatri politik në përgjithësi, zhvillimi i këtij teatri në Gjermani dhe kontributi i Brehtit në fushën e teatrit politik. Në këtë kapitull është marrë në shqyrtim edhe teatri politik në Shqipëri, i përfaqësuar deri në vitet '90 me teatrin e agjitpropit si shembull ekstremisht i politizuar i teatrit politik. Një rëndësi e veçantë në këtë kapitull i kushtohet teorisë së Brehtit mbi fashizmin si dhe dramave antifashiste të tij. Ndër dramat antifashiste të Brehtit merren në shqyrtim dramat “Koka rrumbullake dhe koka majuce”, “Frikë dhe mjerim në Rajhun e Tretë”, “Shën Johana e therrtoreve” etj. Si model i teatrit politik analizohet drama “Arturo Ui”, në të cilën hiqen paralele midis ngjarjeve dhe personazheve në dramë me zhvillimet në

*Gjermani dhe ardhjen e Hitlerit në pushtet. As këtu nuk lihen jashtë vëmendjes elementet epike dhe realizimi dramaturgjik nëpërmjet efekteve tjetërsuese në disa rrafshe, duke synuar evidentimin e mundësive që krijon ky lloj teatri në risjelljen në sytë e publikut të figurave dhe ngjarjeve të ndryshme historike, madje edhe nga historia jonë.*

**Kreu V** paraqet një studim mbi kushtet e krijimit të veprave dramaturgjike, sjelljen përpara publikut dhe vënien në skenë të veprave të Brehtit, varësisht nga kushtet historiko-shoqërore dhe zhvillimet politike në Gjermani. Këtu trajtohet gjerësisht dhe suksesi ndërkombëtar i dramave të Brehtit, receptimi i veprave në botë dhe në Shqipëri. Një vend të veçantë në këtë kapitull zë debati i kritikës gjermane për veprat e Brehtit dhe ndarja e saj në dy kampe kryesisht për shkak të përmbajtjes ideologjike dhe mbështetjes së autorit në teorinë marksiste. Po në këtë kapitull merren në shqyrtim koncepte epike të bashkëkohësve të Brehtit dhe nënvizohet aktualiteti i teatrit epik, ilustruar dhe me vënien e vazhdueshme në skenë të pjesëve të tij deri në ditët e sotme.

**Në kreun e fundit** përmbliidhen përfundimet kryesore të këtij studimi, theksohen vlerat e njohjes që ofron ky studim dhe mundësitë e vënies në dobi të teatrit në Shqipëri.

*Metoda e studimit e përdorur në këtë punim është ajo sintetike, që nënkupton shqyrtimin e tipareve të veprës dramaturgjike të Brehtit, e ndërthurur kjo me elemente analitike, duke e krahasuar dramën brehtiane me dramën e traditës dhe atë bashkëkohore, për të arritur tek një vlerësim sa më i plotë i risive që solli Brehti në kulturën teatrore botërore.*

*Tekstet letrare në këtë punim janë analizuar duke përdorur koncepte të kritikës letrare bashkëkohore. Pjesë e metodologjisë do të jetë krahasimi në rrafshin tematik, estetik, stilistikor dhe gjuhësor.*

*Në këtë punim është përdorur një korpus i gjerë letrar në përmbushje të nevojave të punimit. Për një analizë sa më të plotë janë marrë si referencë krahasuese teoricienë të ndryshëm të poetikës së dramës, që nga Aristoteli, Niçeja, Hegeli, Szondi, Adorno etj, si edhe është bazuar në studime biografike, interpretative apo ese studimore të botuara në botë lidhur me këtë temë. Literatura e përdorur ka qenë kryesisht në gjuhën gjermane dhe në gjuhën shqipe dhe pjesërisht në atë italiane, angleze dhe franceze.*